



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË



Drejtoria e Inspektoratit

Për: z.Ragip Begaj , Kryetar i Komunës së Malishevës

Nga: Dibran Kastrati , Drejtor Drejtorisë së Inspektoratit _____

Lënda: Raport i punës 01/01 - 30/06/2018

I nderuar

Keni të bashkangjitur raportin e punës gjashtë mujore të Drejtorisë së Inspektoratit për vitin 2018

Me respekt !

Raporti gjashtë mujor i punës

Drejtoria e Inspektoratit në Komunën e Malishevës edhe në këtë periudhë gjashtë mujore është angazhuar maksimalisht për kryerjen e detyrave të punës për të cilat jemi të ngarkuara. Në këtë gjashtë mujorë të raportimit kemi vazhduar bashkëpunimi me Policinë e Malishevës në rastet e përgjithshme kryesisht në asistim, bashkëpunimi ka qenë shumë i mirëpo ashtu sikur edhe viteve tjera në këtë gjashtë mujor lëndët e kundërvajtjes që janë dërguar në gjykatë nuk po shqyrtohen dhe ka shumë lëndë të mëhershme që po parashkruhen vazhdimisht.

Gjatë këtij gjashtëmujori në drejtorinë tonë kemi pranuar gjithsej 42 kërkesa nga qytetarët si dhe nga persona përgjegjës të subjekteve afariste, andaj si Drejtori të gjitha kërkesat i kemi shqyrtuar (dy kërkesa janë në shqyrtim e sipër). Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 230 procesverbale, i kemi parashtruar disa kërkesa te ndryshme Policisë kryesisht për asistim. Në këtë periudhë raportuese drejtoria e Inspektoratit ka realizuar këto detyra si më të rëndësishme:

1- Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga qytetarët dhe bizneset për licencime.

2 -Kontrollimin-inspektimin e përgjithshëm të terrenit .

-Ne si drejtori kemi marr pjesë në disa komisione të ndryshme për performancë komunale.
-Kemi bërë inspektimin dhe parandalimin e hedhjeve të plehrave natyror në sipërfaqet publike në fshatrat e komunës. -

Pas ankesave të banorëve është bërë kontrollimi dhe inspektimi i rrjetit të kanalizimit nëpër ato fshatra ky ka pas problem , ku kryesisht këto kërkesa kanë qenë ankesa në lidhje me bllokimin e kanalizimeve e për të cilat varësisht nga natyra e bllokimit ju kemi rekomandua organeve përkatëse kompetente, drejtorisë komunale për Urbanizëm dhe asaj për Shërbime Publike, kompanisë publike për ujësjellës dhe kanalizim në Malishevë për mënjanimin e problemit, edhe në këtë gjashtë mujor të raportimit shqetësuese është bllokimi i herë pas herëshem i kolektorit kryesor të ujërave të zeza në disa vende e që derdhen në lumin Mirusha.

-Edhe këtë vit është bërë evidentimi i të gjitha pikave të mbeturinave në tërë territorin e komunës se Malishevës dhe është bërë rekomandimi për pastrimin e tyre.

-Kemi kontrolluar dhe monitoruar ne fshatrat Ngucat, Bardh, Fshat i Ri, për furrat gëlqerore për arsye të mos djegies së gomave të automjeteve , kemi pas raste që kemi hasur në djegie të gomave dhe kemi ndaluar menjëherë vazhdimin e djegies dhe njëkohësisht kemi dërguar lëndë në gjykatë për procedurë për kundërvajtje për ata persona . -

Është bërë kontrollimi i subjekteve afariste në Malishevë dhe në të gjitha fshatrat e Malishevës të cilat e ushtrojnë veprimtarin e tyre pa regjistrim të bizneseve dhe njëkohësisht u janë dhënë vërejtje gojore dhe me shkrim për regjistrim të bizneseve, ndërkohë shumë biznese të ndryshme janë regjistruar (56 subjekte).

-Drejtoria e Inspektoratit gjatë periudhës gjashtë mujore ka shpërnda më shumë se 60 vërejtje me shkrim për subjektet afariste të cilat nuk e kanë paguar me rregull taksën komunale.
-Në bashkëpunim me Policinë Regjionale-Gjakovë, njësinë kundër trafikimit me qenie njerëzore kemi kontrolluar të gjitha lokalet restorantet të ashtuquajtura si klube të natës dhe njëkohësisht edhe kemi bërë mbylljen e atyre lokaleve që nuk kanë pasur dokumentacion të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë afariste, njëkohësisht në mungesë dokumentacioni kemi bërë mbylljen e një lokali në Malishevë të ushtrimit të veprimtarisë afariste (për masazh).

- Në bashkëpunim me Policinë e Malishevës kemi bërë mbylljen e një bastoreje që është hapur me afër se 500 m. nga institucionet shkollore dhe ato publike, në kundërshtim me ligjet në fuqi.
-Janë kontrolluar të gjitha subjektet afariste të cilat merren me tregtimin e artikujve ushqimor për kontrollimin e artikujve për afat të skadencës. Kemi hasur shumë pak artikuj me afat të skaduar, artikuj me çmim prej 18.⁰⁰ €, në përgjithësi, vlen të ceket se është një vetëdijesim i mirë edhe i tregtarëve edhe i qytetarëve, dhe nuk ka raste si viteve të mëhershme.
-Kemi kontrolluar subjektet afariste për respektim të orarit të punës gjatë orëve të mbrëmjes -
Janë bërë kontrollime të subjekteve afariste si restorante, farmacitë, ëmbëltoret, furrat e bukës dhe janë urdhëruar që të bëjnë pastrimin e rregullt si është e paraparë të hapësirës dhe njëkohësisht ta bëjnë DDD-në.

-Janë kontrolluar të gjitha shkollat e mesme dhe ato fillore të komunës së Malishevës , kontrollimi është bërë për mirëmbajtjen e pastërtisë në përgjithësi të objekteve shkollore, ku njëkohësisht edhe janë dhënë vërejtje, sugjerime dhe urdhëresa për pastërtinë në ato shkolla ku nuk ka qenë niveli i duhur për pastërti.

-Kemi kontrolluar të gjitha restorantet e komunës së Malishevës me qëllim të verifikimit të zbatimit të ligjit për ndalimin e pirjes së duhanit në hapësirat e mbyllura, e sidomos janë kontrolluar dhe inspektuar disa herë në bashkëpunim me Policinë e Malishevës lokalet që janë në afërsi të shkollave ku me këtë rast edhe kemi proceduar lëndë për gjykatën komunale si dhe kemi shqiptuar gjobë mandatore për ata që janë hasur në kundërshtim me ligjin për kontrollin e duhanit.
- Kemi lëshuar pëlqime minimale teknike dhe sanitare për subjektet afariste që janë të obliguara të kenë ato.

-Me rastin e afrimit të korrje-fshirjes janë kontrolluar mullinjtë në komunën tonë (4 mullinj) si dhe të gjitha pikat tjera lëvizëse (mobile) grumbulluese të grurit për nivelin e përgjithshëm të pastërtisë.

Është bërë ndalimi i shitjes së mallit jashtë hapësirave të caktuara për shitjen e tyre (mos ekspozimi i tepërt i mallit para lokaleve), jemi duke bërë ndalimin e shitësve ambulator në qytet edhe pse ende kemi shumë probleme me shitës ambulator dhe atë për arsye se nuk ekziston tregu ditor.

-Kontrollohen rregullisht tregjet javore si ai i gjelbër, autotregu dhe tregu i kafshëve për mirëvajtjen e tyre në përgjithësi.

Kemi kontrolluar të gjitha objektet hoteliere si dhe kemi bërë shpërndarjen e urdhëresave të dhëna nga MTI për licencim dhe ri licencimin e të gjitha hoteleve dhe moteleve.

-Kemi marr pjesë ne komisionin për ndarjen e vijave urbane, është bërë kontrollimi i kompanive transportuese, i taksive i auto transportuesve, është bërë kontrolli për mos lejim të operimit të kombi taksive dhe te taksive pa leje komunale në territorin e komunës sonë .

-Është bërë në veçanti kontrollimi i mishit dhe të produkteve të tij nëpër të gjitha subjektet afariste që tregtojnë si dhe kontrollimi i mishoreve në tërë Malishevën për verifikim të kushteve se sa i plotësojnë ato.

Kontrollimin dhe monitorimin e kompanisë e cila ka bërë dezinfektimin selektiv kundër rriqrave. Me rastin e 1-majit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kemi bërë ndalimin e ekskursionit të nxënësve të klasave të dhjeta të shkollës së mesme për Prishtinë sepse organizimi i ekskursionit (vetë organizim) ka qenë në kundërshtim me udhëzimin administrativ për këto aktivitete . Kemi bërë kontrollimin i ndërtimeve në përgjithësi dhe eliminimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore, kemi pas rast të fillimit të ndërtimeve të objekteve pa leje ndërtimore dhe kemi bërë ndërprerjen e punimeve si dhe njëkohësisht kemi proceduar lëndën për gjykatën komunale për kundërvajtje - Po ashtu është ber kontrolli i ndërtimeve me Leje se a janë duke e respektuar investitorët lejen e ndërtimit të dhënë.

Në bazë të treguesve dhe rezultateve të arritura gjatë 6 mujorit të këtij viti, konstatojmë se në nivel të këtij sektor, është ngritur disiplina në punë, efikasiteti, azhuriteti dhe cilësia e inspektimeve.

Pasqyra e punëve të përgjithshme të drejtorisë së Inspektoratit në mënyrë tabelore

Lënda	Proces Verbale	Aktvendime Vendime Pëlqime	Urdhëresa Vërejtje	Kërkesa Gjykatës	Kërkesa të ndryshme Policisë	Kërkesa të pranuara	Shqyrtimi kërkesave	Shuma mall.asgj.€	Të hyra dhe Gjoha Mandatore	i Inkasim tax.komun.€	Shperndarje aktv.tax.kom	Regjistrime të reja biznesore
	230	17	25	6	6	42	40	18.⁰⁰	430 €	8675 €	xxxx	56